



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:116088

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844242

CT.nr.29/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në procedurën jokontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësit H (I) I ish nga Rahoveci, duke vendosur lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës për shqyrtimin e trashëgimisë, më datën 21.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Pas të ndjerit H (I) I ish nga Rahoveci, me numër personal, i cili ka lindur më data..., ndërsa ka vdekur më data..., kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, ndërsa pasurin e paluajtshme e ka ndarë me testament, shtetas i Republikës së Kosovës, SHPALLET për trashëgimtar, në bazë të trashëgimisë e me obligim të kthimit të borxheve eventuale të trashëgimlënësit, deri në lartësinë e vlerës së trashëguar:

- I. E (H) I, nga Rahoveci, me numër personal, përndryshe biri i të ndjerit, shpallet pronar në këtë masë trashëgimore, respektivisht në pasuri të luejtshme si në vazhdim: xhirollogarinë bankare me nr..... pranë B për, me seli në Prishtinë, në të cilën xhirollogari ka mjete të deponuara.
- II. Detyrohet trashëgimtar i shpallur E (H) I që kësaj gjykate t’ia paguajë taksën gjyqësore për shqyrtimin e trashëgimisë, në shumën prej 50.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate është iniciuar procedura e trashëgimisë pas vdekjes së trashëgimlënësit H (I) I ish nga Rahoveci, pasuria e të cilit është përshkruar në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata gjatë procedurës dhe nga shkresat e lëndës ka vërtetuar se i ndjeri ka pasur banimin e fundit në territorin e kompetencës territoriale të kësaj gjykate, se ka vdekur më 10.12.2020, pa lënë kontratë mbi mbajtjen e përjetshme, ndërsa pasurin e paluajtshme e ka ndarë me testament dhe se prej trashëgimtarëve të rendit të parë të trashëgimisë ka lënë trashëgimtarët dhe atë: të bijën B.I-D dhe të birin E.I.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje të trashëgimisë, më datë 13.06.2024, ku trashëgimtari E.I, ka pranuar që të shpallet trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerit në pjesët që i takon sipas ligjit dhe në pjesët që eventualisht dikush prej trashëgimtarëve heq dorë të interes tyre, ndërsa trashëgimtarëve të tjerë nuk ua kanë mohuar të drejtën për trashëgimi, ndërsa e bija e trashëgimlënësit: B.I-D, ka pranuar që të shpallet trashëgimtarë në pasurinë e të ndjerit, mirëpo nga kjo e drejtë ka hequr dorë në favor të vëllait të saj E.I.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neneve 12, 119 dhe 135 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, si dhe në dispozitat e neneve 125, 128 dhe 162.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CT.nr.29/2023, më datë 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykat